



Nr. 18/1 prot  
Shkodër, 14/06/2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



**V E N D I M**

**Nr. 4 Datë 07.03.2018**

**PËR MOSMIRATIM NË PARIM TË KËRKESËS PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE SUBJEKTIT "COMPANY RIVIERA 2008"SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, " Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni", për paisjen me autorizim (miratim në parim) të subjektit "**COMPANY RIVIERA 2008**" sh.p.k., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

**V e n d o s i:**

- 1-Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit "**COMPANY RIVIERA 2008**" sh.p.k., me administrator Z.Agim KOLA, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Rishtit**, (degë e Lumit Drin i Zi), për prodhim energjie elektrike (HEC RISHT), në fshatin Midhe, Njësia Administrative Qelëz , Bashkia Pukë, Qarku Shkodër.
- 2-Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsytet e mëposhtme:
  - Vështirësonte jetën sociale dhe ekonomike të banorëve të fshatrave Midhe dhe Bushat.
  - Shkatëron mjedisin dhe turizmin.
  - Zbatimi i këtij projekti shkakton konflikt të jashtëzakonshëm.
- 3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETAR**

**Raimonda GURI**



**KRYETAR**

**Çesk MILLJA**

